



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNËS -MALISHEVË

30-06-2020

CA-585

Zyra e Personelit

Nr.01/

Më:30/06/2020

Në mbështetje të dispozitave të nenit 18 dhe nenit 27, të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenit 5 i të Rregullores Nr. 21/2012, për Avancim në Karrierë të Nëpunësve, si dhe neni 16, paragrafi 1, pika 1.1, 1.2.1.3 dhe 1.7, të Rregullores për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Udhëheqësi i Personelit shpall:

KONKURS TË BRENDSHËM

I. DREJTORIA PËR GJEODEZI DHE KADASTERE

I.(Një) Udhëheqës I sektorin për Gjeodezi

Kualifikimet dhe shkathtësitë e kërkuara: Diplomë universitare, drejtimi i gjeodezisë,

Përvojë pune: 4 vite përvojë pune profesionale;

-Shkathtësi të lartë në menaxhim, organizim, caktim të objektivave dhe planifikim;

-Njohuri të mira për mbikëqyrje efektive të punës profesionale të kryer nga vartësit;

Kohëzgjatja e emërimit: Nëpunës i karrierës.

Koeficienti: 7.5

Kodi i vendit të punës KG/020

Numri i referencës:

Përshkrimi i detyrave të punës:

- Udhëheqë punën e përgjithshme të sektorit dhe ndihmon drejtorin në caktimin e objektivave dhe zhvillimin e planit të punës për përmbushjen e këtyre objektivave si dhe harton planin e punës për sektorin
- Menaxhon stafin e sektorit, dhe organizon punën përmes ndarjes së detyrave tek të varurit, si dhe ofron udhëzime dhe monitoron punën e stafit;
- Në bashkëpunim me drejtorin, bënë vlerësimin e proceseve dhe procedurave të brendshme dhe rekomandon ndryshime dhe përmirësime me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe cilësisë së punës;
- Siguron matjet dhe incizimet gjeodezike të të gjitha profileve dhe grumbullimin e të dhënave të pasurisë së paluajtshme në terren me qëllim të regjistrimit në sistemin e kadastrit dhe rregullimin e kufijve të pasurive të paluajtsh
- Harton detyrat projektuese për objektet e infrastrukturës pas dhënies së kushteve urbanistike nga sektori i urbanizmit dhe rekomandon dinamikën e kryerjes së punëve, realizimit të projekteve;
- Siguron përgatitjen e dokumenteve e nevojshme për infrastrukturën rrugore përfshirë incizimet gjeodezike të të gjitha profileve dhe paraqet në mënyrë grafike rrugët, kanalizimin, rrjetin e ujësjellësit, rrjetin elektrik, parkingjet dhe shtigjet e këmbësoreve;
- Udhëzon ekipin në përgatitjen e elaboratit kadastral, planeve, foto-skicave, si dhe përgatitjen e terrenit për rilevim dhe matje si dhe aprovon të gjitha dokumentet që lëshohen nga ky sektor;
- Bën vlerësim të rregull të stafit nën mbikëqyrje të tij dhe përkrahë zhvillimin e tyre përmes trajnimeve për të siguruar kryerjen e detyrave të tyre në nivel me standardet e kërkuara;

Dokumentet e kërkuara

- Diploma universitare
- Letërnjoftimi (fotokopje);
- Certifikata e lindjes;
- Certifikata për trajnimet e kryera;
- Dëshmi qe nuk është nën hetime
- Vërtetimin e përvojës së punës;

Afati për paraqitjen e dokumentacionit është 8 ditë nga dita e shpalljes së konkursit.

Të gjithë të interesuarit që dëshirojnë të aplikojnë në këto vende të punës janë të obliguar që t'i marrin dhe dorëzojnë aplikacionet në **Zyrën për pritjen e palëve** të KK- Malishevë. Konkursi do te publikohet në të përditshmen "Epoka e re", në faqen zyrtare te Komunës dhe në tabelë të shpalljeve të **KK- Malishevë**.

Për intervistë do të njoftoheni me kohë.

Udhëheqësi i Personelit

Gani Bahtjari, jur.dipl.

